



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 690/ 6 prot

Datë 06.04.2024

V E N D I M

Nr. 347 /2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 06.04.2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Vendim për mbylljen e çështjes për ankesën e operatorit ekonomik “4S” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-93348-01-18-2024, me objekt “Loti 5 Fruta perime” me fond limit 3,398,550.16 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 08.02.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Gjirokastrë.

Ankimues: Operatori ekonomik “4S” SHPK me NIPT L64425401K dhe adresë: Lagjja “Xhevdet Nepravishta”, Rruga “Qerim Arapi”, Godina 196, Pasuria nr.23/104-N4 Lushnje.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Gjirokastrë.
Adresa: Sheshi “Çerçiz Topulli”, Gjirokastrë.

Baza Ligjore: Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”. Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë

5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 19.01.2024, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-93348-01-18-2024, me objekt “Loti 5 Fruta perime” me fond limit 3,398,550.16 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 08.02.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Gjirokastër.

II.2. Në datën 08.02.2024, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 06.03.2024, operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave për vlerat pa TVSH si më poshtë:

1. “4 S” SHPK	me oferte	2.580.540 Lekë pa TVSH	skualifikuar
2. “NELSA” SHPK	“	2 917 366 “	kualifikuar

3. “M.C.CATERING” SHPK	“	2.929.406	“	kualifikuar
4. “SOFIA MYFTARI” P.F	“	3.313.841	“	kualifikuar

II.4. Nga verifikimet në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, rezulton, se më datë 19.03.2024 është publikuar njoftimi i fituesit për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Nga verifikimet në Sistemin e Prokurimeve Elektronike rezulton, se operatori ekonomik “4S” SHPK është i skualifikuar për arsye se:

“Nga shqyrtimi dhe kontrolli i dokumenteve administrative - ligjore, teknike - ekonomike e financiare të paraqitura rezultoi, se ky operator ekonomik kishte mangesi dhe nuk i plotesonte të gjitha kriteret e pergjithshme dhe të vecanta të kualifikimit të percaktuara në DST. OE 4S mbeshtet kapacitetet teknike të OE Dajti Park 2007 shpk, kjo në kundërshti me kërkesat e DST të AK si më poshte:

2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:

Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilin ofertuesi nuk lejohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Po

Jo

II.6. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 25.03.2024, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 690 prot., e operatorit ekonomik “4 S” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-93348-01-18-2024, me objekt “Loti 5 Fruta perime”, me fond limit 3,398,550.16 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 08.02.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Gjirokastrë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua, se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “4 S” SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 690/2 prot., datë 26.03.2024.

II.8. Me shkresën nr. 2284/1 prot., datë 02.04.2024, protokolluar me tonën me nr. 690/3 prot., datë 05.04.2024, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së ankimuesi bashkëlidhur së cilës gjendet Shkresa: *Kthim - përgjigje operatorit ekonomik “4S” ShPK, per dijeni KPP-së, mbi shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues ku është vendosur pranimi i ankesës.*

Konkretisht, Autoriteti Kontraktor ka pranuar ankesën me arsyetimin si vijon:

“Autoriteti kontraktor mori në administrim dokumentin e ankesës për procedurën e prokurimit me objekt: “Furnizime dhe shërbime me ushqim për mencat dhe qendrat komunitare, Loti 5 Fruta perime” me fond limit 3,398,550.16 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 08.02.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Gjirokastrë.

Në ankesën tuaj Ju pretendoni se në pikën 2.16 të DST citohet se:

2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:

Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilin ofertuesi nuk lejohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Po

Jo

x

Në bazë të kësaj pike pretendimi juaj është se nga ana e AK-së është bërë një keqinterpretim duke shkaktuar skualifikim e operatorit ankimues.

Ju pretendoni se AK duke zgjedhur opsionin “JO” do të thotë se kjo e fundit lejon mbështetjen në subjekte të tjera dhe duke mos specifikuar detyrat, punët aspektet kritike që nuk lejohen, tregon që operatori ekonomik mund të mbështesë kapacitetet në çfarëdo pike të kërkuar në DST.

Si rrjedhojë operatori ekonomik kërkon rivlerësim dhe kualifikim të këtij të fundit.

Argumenti i AK.

Me pikën e sipërcituar është bërë një keqinterpretim ligjor nga ana e AK konkretisht nga ana e KVO-së ku duke zgjedhur opsionin JO është kuptuar se nuk lejohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Për sa më sipër, në cilësinë e Zyrtarit të Autorizuar të Autoritetit Kontraktor vlerësoj dhe vendos të pranohet ankesën tuaj në bazë të nenit 114 të LPP-së.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “4S” SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimit të tij nga procedura e prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1 Me shkresën nr. 2284/1 prot., datë 02.04.2024 protokolluar me tonën me nr. 690/3 prot., datë 05.04.2024, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacioni i

autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së ankimesi bashkëlidhur së cilës gjendet Shkresa: *Kthim - përgjigje operatorit ekonomik "4S" ShPK*, per dijeni KPP-së, mbi shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes, ku është vendosur pranimi i ankesës.

Konkretisht, Autoriteti Kontraktor ka pranuar ankesën me arsyetimin si vijon:

"Autoriteti kontraktor mori në administrim dokumentin e ankesës për procedurën e prokurimit me objekt: "Furnizime dhe shërbime me ushqim për mencat dhe qendrat komunitare, Loti 5 Fruta perime" me fond limit 3,398,550.16 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 08.02.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Gjirokastrë.

Në ankesën tuaj Ju pretendoni se në pikën 2.16 të DST citohet se:

2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:

Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilin ofertuesi nuk lejohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Po



Jo



Në bazë të kësaj pike pretendimi juaj është se nga ana e AK-së është bërë një keqinterpretim duke shkaktuar skualifikim e operatorit ankimes.

Ju pretendoni se AK duke zgjedhur opsionin "JO" do të thotë se kjo e fundit lejon mbështetjen në subjekte të tjera dhe duke mos specifikuar detyrat, punët aspektet kritike që nuk lejohen, tregon që operatori ekonomik mund të mbështesë kapacitetet në çfarëdo pike të kërkuar në DST.

Si rrjedhojë operatori ekonomik kërkon rivlerësim dhe kualifikim të këtij të fundit.

Argumenti i AK.

Me pikën e sipërcituar është bërë një keqinterpretim ligjor nga ana e AK konkretisht nga ana e KVO-së ku duke zgjedhur opsionin JO është kuptuar se nuk lejohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Për sa më sipër, në cilësinë e Zyrtarit të Autorizuar të Autoritetit Kontraktor vlerësoj dhe vendos të pranoj ankesën tuaj në bazë të nenit 114 të LPP-së.

III.1.2. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: *"Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera".*

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 *"Për Prokurimin Publik"* i cili parashikon shprehimisht se: *"Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe*

vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

III.1.4. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk ka pretendime apo argumente nga subjekte të interesuara pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me nenin 113 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”.

Për këtë fakt, bazuar në nenin 115, pika 1 dhe 3 dhe nenin 118, të ligjit nr. 162/2020, “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Komisioni do të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur të operatorit ekonomik “4 S” SHPK, për procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30, 115 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “*Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “4S” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-93348-01-18-2024, me objekt “Loti 5 Fruta perime” me fond limit 3,398,550.16 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 08.02.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Gjirokastrë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Autoriteti Kontraktor të kualifikojë operatorin ekonomik “4S” SHPK sipas vendimmarjes së KSHA-së .
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “4S” SHPK.
5. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri

